

ALBANIAN ICT AWARDS



HYRJE

Objektivi i këtij evenimenti është identifikimi dhe shpërblimi i profesionistëve të shquar, udhëheqësve të suksesshëm, inovatorëve, profesorëve, yjeve në ngritje të cilët gjatë një vitit kalendarik kanë arritur të lënë gjurmë pozitive dhe kontribut në sektorin e gjerë të ICT-së.

Në vazhdim do të gjeni një përmbledhje për tre edicionet e Albania ICT Awards për vitet 2013, 2014 dhe 2015.

ALBANIAN ICT AWARDS -2013 –EDICIONI I I-RE



Albanian ICT Awards 2013 është mbyllur me sukses mbrëmjen e së premtes, më 26 prill 2013, duke kurorëzuar fituesit në Mbrëmjen Gala të ndarjes së çmimeve. Çmimet për fituesit e pesë kategorive, të shoqëruara njëkohësisht edhe me vlerësime të tjera për të nominuarit më të mirë të garës u ndanë në një ambient të përbërë nga profesionistë të shquar të fushës, ku nuk munguan edhe personalitete të rëndësishme si Ministri i Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, Genc Pollo, Ministri i Financave të Kosovës, Ramadan Avdiu, Ambasadori Amerikan në Shqipëri Alexander Arvizu dhe ambasadori i Bashkimit Europian, Ettore Sequi.

Albanian ICT Awards është event i parë i këtij lloji në Shqipëri, që simbolizon mirënjohjen, falënderimin dhe shpërblimin për punën e madhe dhe kreative përmes së cilës individët apo grupet e punës kanë arritur të ndikojnë në zhvillimin e ideve inovatore.

Kushtrim Shala, menaxheri i eventit, falenderoi të gjithë sponsorët dhe partnerët që kanë mbështetur këtë garë përgjatë gjithë muajve të organizimit të saj. Sipas tij, aktivitete të tilla që kanë në qendër të vëmendjes individin dhe forcën kreative të tij, kanë qëllim të nxisin konkurrencën, t'i japin shtysë zhvillimit të sektorëve të ndryshëm të biznesit si dhe të ndikojnë pozitivisht në rekrutimin dhe lindjen e profesionistëve me vlera dhe potenciale reale në

treg. Ai shtoi se kompania ICTSmedia, lidere në botimet mediatike të fushës së ICT-së përmes revistave të mirënjohura në tregun shqiptar si Computerworld Albania, PCWorld Albanian, CIO Albania, GameWorld.al, synon ta kthejë këtë event në një institucion të ri vlerësimi dhe promovimi të individëve të suksesshëm si dhe njëkohësisht në një traditë të përvitshme mbarëkombëtare në sektorin ICT-së.

Ministri Genc Pollo vlerësoi eventin për rëndësinë dhe vlerësimin që i jep individit dhe forcës së tij krijuese. Ismet Hamiti, në emër të jurisë, u shpreh se edicioni i parë i këtij eventi ishte i shoqëruar me një numër të madh aplikimesh inovative të cilat vlerësohen me një impakt të rëndësishëm pozitiv në shoqërinë, biznesin dhe akademinë mbarëshqiptare. Vjollca Dako, drejtoreshë e Fondacionit “Dritan Hoxha”, një ndër mbështetësit kryesorë të Albanian ICT Awards që në fazat fillestare të tij, e lidhi këtë partneritet me konceptin dhe filozofinë e gjithë Top Medias, si një institucion që synon të çojë përpara teknologjinë shqiptare përmes individëve dhe punës së tyre pasionante në këtë fushë. Edlira Kasaj, drejtoreshë e Qendrës PROTİK në Tiranë, u shpreh se Albanian ICT Awards ishte një provë e dukshme se në trevat mbarëshqiptare ka talente të pamohueshëm në fushën e ICT-së, duke vënë theksin në të rinjtë nën 18 vjeç të cilët ajo i ndjek prej muajsh në Qendrën që drejton. Enkelejd Zotaj, CIO në Raiffeisen Bank Albania, vlerësoi gjithashtu eventin për nxitjen dhe motivimin që u jep të gjithë talentëve në këtë fushë. Dino Walsh, menaxher i përgjithshëm i kompanisë ICTSmedia, i cili mbështet këtë event me eksperiencën e tij të gjerë në tregjet globale, u shpreh se Shqipëria është një vend me një potencial të rëndësishëm i cili meriton vlerësim dhe nxitje të metejshme, dy misione që karakterizojnë garën e Albanian ICT Awards.

Të gjitha aplikimet u shqyrtuan dhe u vlerësuan nga një juri profesioniste, e cila u mblodh para pak javësh për të dhënë verdiktin final dhe për të përcaktuar fituesit.

Edhe pse zhvillohet për herë të parë këtë vit, gara e Albanian ICT Awards 2012 ka pasur prurje të arrira nga të gjitha trevat shqiptare, si Mali i Zi, Maqedonia, Kosova, Shqipëria si dhe shqiptarë me banim në vende të ndryshme të Evropës. Juria ishte e përbërë nga emra të shquar të akademisë, biznesit dhe informatikës si Ismet Hamiti, Kozeta Sevrani, Endri Hasa, Endri Xhina, Arsen Kurti, Visar Jasiqi, Enkelejd Zotaj, Rahmil Limani dhe Igli Gjelishti.

Axhenda e mbrëmjes vazhdoi me ndarjen e çmimeve, vlerësimeve dhe certifikatave për të nominuarit dhe fituesit e kategorive përkatëse. Pesë fituesit e mëdhenj përfituan një çek prej 500 EUR nga Raiffeisen Bank, çek për tërheqje të tableteve Lenovo nga Vodafone Albania, trajnime nga

Universiteti Amerikan në Kosovë si dhe çmime të tjera simbolike. Njëkohësisht, ata do të kenë mundësi të prezantojnë punët e tyre për publikun e gjerë përmes intervistave ekskluzive në numrin e ardhshëm të revistës COMPUTERWORLD Albania, e cila do të dalë në treg në muajin maj.

Fituesit e kategorive ishin:

ICT Creativity of the Year (Kreativiteti TIK i vitit): BETIM DRENICA

ICT Mobility of the Year (Mobiliteti TIK i vitit): JULIAN KANINI

ICT Academic of the Year (Akademiku TIK i vitit): MARENGLLEN BIBA

ICT Diploma Thesis of the Year (Tema e Diplomës TIK e vitit): BARDH LOHAJ

ICT Rising Star of the Year (Ylli në Ngritje TIK i vitit): ELIO QOSHI

Çmime mirënjohje, në shenjë nderimi për kontributin e dhënë në sektorin e ICT morën edhe kryetari i jurisë, Ismet Hamiti dhe profesor Neki Frashëri, ndërsa çmime inkurajimi u dhanë për dy të rinjtë Hysen Ndregjoni dhe Denis Avdiu.

Evenimenti u sponsorizua nga Raiffeisen Bank Albania, Vodafone Albania dhe kompania Albvision, me mbështetjen e partnerit strategjik Fondacioni “Dritan Hoxha” si dhe të partnerëve të tjerë si PROTIK, AUK, AITA, Portali Albeu.com dhe Microsoft.

ICTSmedia ka planifikuar takime pune me fituesit e kategorive, me qëllim zbërthimin e mëtejshëm të projekteve dhe ideve të fituesve dhe promovimin e tyre në vazhdimësi.

ALBANIAN ICT AWARDS II- 2014-EDICIONI I II-TË



Në një Natë Gala, ashtu si tradita e edicionit të kaluar, “Albanian ICT Awards II” u mbyll me sukses duke kurorëzuar edhe fituesit për pesë kategoritë e çmimeve. Në këtë eveniment dhe ceremoni të veçantë nderuan me pjesëmarrjen e tyre kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ministrja e Inovacionit dhe Administratës Publike, Milena Harito, ministrja e Arsimit dhe Sportit Lindita Nikolla, Bernard Nikaj, ministër i Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës, Mimoza Kusari (Lila), kryetare e Komunës së Gjakovës, përfaqësues të botës akademike, biznesit, artit dhe medias. Këtij eventit nuk mund t’i mungonin inovatorët, sidomos ata më të spikaturit e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në gjithë hapësirën mbarë shqiptare, si ekspertë, menaxherë, përfaqësues të botës akademike dhe sipërmarrës të suksesshëm në sektorin e ICT-së. Fjalën e hapjes e mbajti njëri ndër themeluesit e “Albanian ICT Awards II”, Kushtrim Shala. -

Radha më pas do vinte momenteve të shumëpritura, pikërisht ndarjes së çmimeve dhe siparin e tyre e hap kryeministri Rama, i cili, i shoqëruar edhe nga ministrat e kabinetit të tij, vlerësoi lart punën e bërë nga “Albanian ICT Awards”, duke e quajtur një investim në vetvete në brendinë e këtij revolucioni për t’i folur të ardhmes me kurajë aty ku të tjerët shohin thjesht dhe vetëm të tashmen. E për t’iu drejtuar të gjithë hapësirës shqiptare, duke i rikujtuar se inovacioni është një vlerë themelore e një kohe tërësisht të re të komunikimit e se në fakt bota është vetëm një fshat global.

“Besoj se zhvillimet në teknologji, dhe veçanërisht në teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit janë si një revolucion, po aq formësues e transformues, për shoqërinë tonë. Unë dua t’i përgëzoj sinqerisht iniciatorët dhe realizuesit e kësaj nisme sepse dëshmojnë për një Shqipëri tjetër. E tek Shqipëria tjetër nuk kam parasysh vetëm Shqipërinë këtu ku jemi mbledhur sot, por edhe Shqipërinë matanë, siç e quante Dritëro Agolli Kosovën, tanimë ka lindur dhe rritet e bashkuar në rrjetin e mirënjohur ndërkombëtar të çmimeve të teknologjinë e komunikimit dhe informacionit që organizohen edhe këtu, njësoj, siç organizohen në Evropë dhe në SHBA”, u shpreh ndër të tjera kryeministri Rama gjatë fjalës së tij.

Fituesit e kategorive ishin:

ICT Creativity of the Year (Kreativiteti TIK i vitit): TODI THANASI

ICT Mobility of the Year (Mobiliteti TIK i vitit): MENTOR PACARADA

ICT Academic of the Year (Akademiku TIK i vitit): KOZETA SEVRANI

ICT Diploma Thesis of the Year (Tema e Diplomës TIK e vitit): LUM ZHAVELI

ICT Rising Star of the Year (Ylli në Ngritje TIK i vitit): EVIS HOXHA

Në fund të fjalës së tij kryeministri Rama dorëzoi çmimin Ylli në Ngritje i Vitit që u fitua nga Evis Hoxha. Kelvin Çobanaj, u rendit në vendin e dytë për kategorinë Ylli në Ngritje i Vitit, ndërsa në vendin e tretë Frenci Rakipi.

- Tani që jemi në vitin e dytë të ICT Awards, një eveniment mbarëkombëtar jo vetëm që u kthye në një skenë të adhuruar dhe të shumëpritur nga talentet e kësaj fushe, por po merr përmasa të një mbështetje serioze si nga bizneset private ashtu edhe nga sektori publik dhe qeverisës”, u shpreh Shala ndër të tjera në fjalën e -

Mes një atmosfere entuziaste vazhdoi edhe shpërndarja e çmimeve të tjera. NickFrydas, provost i University of NewYork Tirana dha çmimin e Diplomës së Vitit, që u fitua nga Lum Zhaveli, ndërsa Klaudio Dervishaj mori çmimin e dytë dhe Erjon Paçarizi çmimin e tretë -

Çmimi TIK Akademiku i Vitit shkoi për profesoreshën e nderuar Kozeta Sevrani, çmim ky që iu dorëzua nga drejtoresha e Fondacionit mediatik “Dritan Hoxha”, ndërsa Elinda Kajo mori çmimin dhe Sokol Kosta çmimin e tretë.

Ndërsa çmimi TIK Inovacioni i Vitit shkoi për Todi Thanasin, çmim që iu dorëzua nga ministrja e Inovacionit dhe Administratës Publike, Milena

Harito, kurse Eridon Hysendhima dhe Besim Dida u renditën në vend të dytë dhe të tretë. TIK Mobiliteti i vitit u fitua nga Mentor Paçarada dhe u dha nga kryetarja e komunës së Gjakovës Mimoza Kusari (Lila), vendi i dytë u fitua nga Besnik Rama, ndërsa në vendin e tretë për këtë çmim u shpall fitues Erion Çuni.

Kjo atmosferë ndarjesh çmimesh u shoqërua edhe me fjalime të veçante nga personalitetet e ftuara në këtë event. Midis tyre ishte Prof.Dr. Petraq Papajorgji, i cili ka kryesuar panelin e jurisë së “Albanian ICT Awards II”. “Transparenca, profesionalizmi dhe objektiviteti kanë qenë parimet e vlerësimit të projekteve të paraqitura. Ju siguroj se disa herë nuk ka qenë e lehtë të përcaktohej fituesi, në disa kategori ka pasur punime shumë të mira, të paraqitura me profesionalizëm të vërtetë. Juria, në të tilla raste, është kthyer tek vlerësimi i dokumentacionit e të përshkimit teknik të projektit. Duke shprehur mendimin e jurisë, dëshiroj të theksoj se në tërësi kemi qenë të befasuar për mirë me nivelin teknik dhe përmbajtjen sociale të punimeve”, u shpreh Papajorgji në fjalën e tij.

Gjithashtu pjesë e mozaikut të fjalimeve ishin edhe ministrja Harito, Nikolla, kryetarja e komunës së Gjakovës Kusari (Lila), ekspertë të TIK-ut në hapësirën shqiptare, drejtoresha e Fondacionit mediatik “Dritan Hoxha”, Vjollca Dako, ndërsa në emër të stafit editorial të ICTSmedia-s dhe medimeve të saj përshëndeti Fatjon Cuka.

ALBANIAN ICT AWARDS III- 2015-EDICIONI I III-TË



Albanian ICT Awards u finalizua mbrëmjen e së premtes, më 15 maj 2015 , me evenimentin tradicional të Mbrëmjes Gala ku bëhet edhe kurorëzimi i fituesve në shtatë kategoritë që kanë qenë edhe objektivi i të gjithë aplikantëve. Ky konkurs mbarëkombëtar, njëkohësisht edhe vlerësimi më i lartë individual në sektorin TIK në hapësirën mbarëshqiptare ka finalizuar përpjekjet disa mujore në kërkim të yjeve inovatorë të teknologjisë së informacionit në mbarë trevat shqipfolëse

Në këtë ceremoni nderuan me pjesëmarrjen e tyre ministrja e Inovacionit dhe Administratës Publike të Shqipërisë, Milena Harito, ministrja e Punës dhe Mirëqënies Sociale në Kosovë, Rita Haizeraj, ish-ministri Mirëqënies Sociale dhe Rinisë së Shqipërisë, Erion Veliaj, përfaqësues të trupit diplomatike të SHBA-ve, udhëheqës të bizneseve dhe organizatave të industrisë së TIK nga Shqipëria e Kosova, si dhe profesionistë të IT-së, akademikë, përfaqësues të universiteteve dhe medias.

Në vitin e tretë, konkursi mbarëkombëtar Albanian ICT Awards shpalosi edhe njëherë gjithë potencialin që zotërojnë trevat shqipfolëse në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Me promovimin e këtyre të rinjve inovatorë, Albanian ICT Awards ka përmbushur qëllimin kryesor identifikimit dhe shpërblimit të këtyre maratonmakëve të sektorit ICT në trevat Shqiptare.

Duke qenë njëkohësisht edhe kryetare e Jurisë, Prof. Dr. Kozeta Sevrani ngriti siparin e disa prej fjalimeve të personaliteteve të shquara. Ajo u shpreh se për jurinë nuk kishte qenë aspak e lehtë të vendoste. “Në themel të gjykimit dhe vlerësimit të projekteve qëndronte paanshmëria dhe profesionalizimi,” u shpreh ajo. Sevrani tha se jo pakë herë juria ishte befasar nga niveli teknik dhe profesional që zotëronin disa prej projekteve të paraqitura. Ajo gjithashtu shprehu falenderimet e saj ndaj ICTSmedia për kontributin që Albanian ICT Awards po jep për shqiptarët

Albanian ICT Awards u organizua në kuadër të Javës së Inovacionit falë marrëveshjes së mirëkuptimit që kishte me Ministrinë e Inovacionit. Dhe pavarësisht një jave intensive, drejtuesja e këtij institucioni, Milena Harito ndër të tjera tha “Pavarësisht se gjendemi në një javë mjaft intensive, si mund të mungoja në Natën Gala të Albanian ICT Awards.” Ajo shprehu kënaqësinë e saj për këtë rini innovative e cila është ashtu siç duan ta shohim të gjithë ne, një promotore e suksesit mbarëkombëtar. Zj. Harito vuri theksin tek një rini bashkëkohore e cila po ec me hapa të shpejtë dhe për këtë ajo përmendi edhe fitoren e ekipit Kosovar në konkursit Nasa Space Apps Challenge, NatEv. Fjalimin e saj e mbylli me një motivim për të gjithë të rinjë duke thënë: “Mos shikoni nesër por shikoni pasnesër sepse teknologjia ecën me një ritëm të paimagjinueshëm.”

Mëpas edhe Zv. Ministria e Punës dhe Mirëqënies Sociale në Republikën e Kosovës, Rita Haizeraj, shprehu admirimin e saj për Albanian ICT Awards.

Ishte Enkelejd Zotaj, Drejtor pranë departamentit të IT-së tek Raiffeisen Bank që filloi ndarjen e çmimeve ku zbuloi se fituesi i ICT Inovacioni i Vitit do të ishte Mërgim Cahani. Kompania e këtij djaloshi quhet Gjirafa e cila është Makinë Kërkimore në Gjuhën Shqipe dhe në një periudhë të shkurtër ka filluar të bëhet një ndër platformat më të rëndësishme nga shqipfolësit nga mbarë bota. Per momentin, ky aplikacion ka rreth 200, 000 përdorues unik, një popullaritet ky që vazhdon të rritet. Mërgimi udhëheq një grup prej 16 personash dhe planifikon që deri në fund të vitit të shtohen edhe 20 persona të tjerë. Në këtë kategori u nominuan edhe Ridvan Aliu (almooc) dhe Gelirt Ramadani (Albanian World Clock).

Fituesit e kategorive ishin

ICT Mobility of the Year (Mobiliteti TIK i vitit): BLENDAR BREGU

ICT Academic of the Year (Akademiku TIK i vitit): EDMOND HAJRIZI

ICT Diploma Thesis of the Year (Tema e Diplomës TIK e vitit): MIRGITA FRASHERI

ICT Rising Star of the Year (Ylli në Ngritje TIK i vitit): KELVIN COBANAJ

ICT Public Administration Service(ICT në Shërbimin e Administratës Publike) – Shërbimi i Ndihmës Ekonomike- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë , Administrata Tatimore e Kosovës

ICT Gender Award (Çmimi i Mirënjohjes Gender në ICT) –LINDITA SHOMO(easypay)

Në kategorinë ICT Ylli në Ngritje i Vitit ishte ish-ministri i Mirëqenies dhe Rinisë, Erion Veliaj që i dorëzoi 16 vjeçarit Kelvin Çobanaj nga Durrësi çmimin përkatës. Aktualisht studion në gjimnazin “Konica” Durrës, dhe është në vitin e parë. Kelvini programon në më shumë se 20 gjuhë programimi. Kjo është hera e dytë për Kelvinin që konkurron në “ICT Awards”. Projekti fitues ishte “Enter Style Lend” është një kompani veshjesh me qera me seli në San Francisco, ku Kelvini është pjesë e rendësishme inxhinierike e saj. Të nominuar ishin edhe dy 18-vjeçarë të tjerë Frençi Rakipi dhe Enes Kristo.

Çmimin ICT Mobiliteti i Vitit u rrëmbye nga Bledar Bregu, të cilin ia dorëzoi Ministrja e Mirëqenies dhe Punëve Sociale Rita Haizeraj. Është themelues i Findit.al një platformë për mbledhjen, organizimin dhe shpërndarjen në formë elektronike të informacionit mbi entitete të të gjitha llojeve (private apo publike) me fokus të veçantë mbi pozicionimin gjeografik. I gjithë informacioni që ofrohet në platformë, nuk është i ofruar nga komuniteti por mbledhet nga operatorët e Find It në terren. Kjo ka bërë të mundur që saktësia e informacionit të jetë shumë e lartë. Të nominuar në këtë kategori ishin edhe Olsi Belishta me projektin nekafe.al dhe Arlind Hajredinaj me aplikacionin Autoshkolla.

Ndërsa drejtorja ekzekutive e Fondacionit “Dritan Hoxha”, Vjollca Dako, fondacioni i cili është një partner strategjik i Albanian ICT Awards për të tretin vit me radhës, na njohu me fituesin e çmimit ICT Diploma e Vitit e cila rezultoi një femër, Mirgita Frashëri. Ajo është nga Tirana, ka studiuar për IT në Universitetin La Sapienza të Romës dhe studimet master i vazhdoi në degën Inxhinieri Informatike pranë Universitetit Politeknik të Tiranës. Tema e diplomës me të cilën merr pjesë në konkurs quhet “Përdorimi i modelit Ising në zgjidhjen e problemeve të tregut financiar”. Motivimi për zhvillimin e kësaj teme diplome është i dyfishtë, thellimi i studimit të simulimeve me karakter financiar dhe njëkohësisht përmirësimi i performancës së simulimeve në mënyrë që t’iu vihet në ndihmë kompanive dhe studiuesve të tregut. Të nominuar në këtë kategori ishin Muhamed Retkoceri me një projekt në fushën e Inteligjencës Artificiale dhe Lavdërim Shala me projektin e quajtur FIEK-SMS.

Gjithashtu ICT Akademiku i vitit do të ishte Edmond Hajrizi, çmim të cilin ia dorëzoi kryetarja e Jurisë, Prof. Dr. Kozeta Sevrani. Ai është themelues, President dhe CEO në Universitetin për Biznes dhe Teknologji; Instituti për Ndërmarrësi, Menaxhment dhe Inxhinieri; Agjencia e Kosovës për Menaxhment; themelues i Librarisë së UBT-së me mbi 200.000 libra – më e madhja në trojet shqiptare. Z. Hajrizi ka një CV të shkëlqyer akademike

ICT Shërbimi Publik i Vitit në Shqipëri shkoi për Ministrinë e Mirëqënies dhe Rinisë ndërsa për Kosovën shkoi për Administratën Tatimore të Kosovës. Këto çmime u dorëzuan nga Ministria Milena Harito dhe Rita Haizeraj respektivisht për Shqipërinë dhe Kosovën. Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë me projektin Ngritja e bazës së të dhënave shtetërore për ndihmën ekonomike është shpallur fitues për çmimin ICT Shërbimi Publik më i mirë i Vitit. Nevoja që çoi në ngritjen e këtij regjstri ishte administrimi jo i mirë i përfitimeve për shkak të mungesës së sistemit të informacionit, mbikëqyrjes dhe kontrolleve.

Administrata Tatimore e Kosovës është fituese me projektin Deklarimi elektronik i tatimeve. Sistemi për Deklarim Elektronik është një aplikacion softuerik. Ky aplikacion mundëson pranimin/dorëzimin e deklaratave dhe pagesave përmes kanaleve elektronike nga tatimpaguesit e regjistruar në sistemin bazë tatimor, duke shfrytëzuar Internetin Publik si medium i komunikimit.

Një ndër rrisitë e këtij viti ishte edhe mirënjohja për Femrën në sektorin ICT e cila iu akordua Lindita Shomos për angazhimin e saj të vyer në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit dhe e-payment. Znj. Lindita Shomo është themeluese dhe Drejtor Ekzekutiv e kompanisë Easypay Albania. Ajo ka një përvojë prej 20 vitesh në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, 15 vite në sektorin financiar dhe 8 vite në sektorin e administrimit të biznesit

Ndërsa evenimenti i Natës Gala po afrohej drejt fundit, u shpërndanë edhe disa mirënjohje për disa nga kandidatët e ICT Awards të cilët kanë dhënë kontribute të veçanta për sektorin ICT në Shqipëri. Ludovik Laventure MPAY, Arber Rrapi doktorim.com, Muhamed Retkoceri për arritjet në NASA Space Apps Challenge me çmimin “People’s Choice Award”, Altin Ukshini – Prishtina HackerSpace, Frenki Ktona dhe Krenare Shala.

Falenderimet e veçanta shkojnë për të gjithë ata që qëndruan përkrah nesh duke filluar me sponsorët: Fondacionin Dritan Hoxha, Raiffeisen Bank, Vala, Albvision, Top Channel, Universitetin e New York-ut, AUK (American Education Kosovo), NextSEO, Albsoft, Institutin Kanadez të Teknologjisë, Abissnet dhe EasyPay. Partner mjaft i rëndësishëm ishte Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike ndërsa përkrahës të këtij evenimenti

ishin edhe Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në Shqipëri e Kosovë (ICTSMedia PR).